

20180831472

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM
RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16 dhe 74/17) në nenin 14-a paragrafi (2) alineja 6 shlyhet.

Neni 2

Në nenin 36-a pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni si dhe dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kushteve nga neni 36 paragrafi (2) i përcakton ministri."

Paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) bëhen paragrafë: (3), (4), (5) dhe (6).

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (4), fjalët: "paragrafi (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (3)".

Neni 3

Pas nenit 98-b shtohet nen i ri 98-v dhe titull i ri si vijojnë:

"Neni 98-v

Mbështetja e shpenzimeve për furnizim të karburantit për mekanizëm bujqësor

(1) Mbështetja e shpenzimeve për furnizim të karburantit për mekanizëm bujqësor është ndihmë dedikuar për kompensim të një pjese të shpenzimeve të ekonomive bujqësore për furnizim të karburantit për mekanizëm bujqësor.

(2) Ndihma nga paragrafi (1) i këtij neni është në lartësi deri në 50% të shpenzimeve të ekonomive bujqësore për furnizim të karburantit për mekanizëm bujqësor por jo më shumë se 100.000 denarë për ekonomi bujqësore.

(3) Ndihma nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet me dhënie të kartelave pagesore për furnizim të karburantit në shumë të caktuar.

(4) Lartësia e ndihmës nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet sipas prodhimeve bujqësore ose grupeve të prodhimeve bujqësore në bazë të shumës së shpenzimeve për karburant që është e nevojshme për përpunim të njësisë së sipërfaqes bujqësore gjatë një viti të prodhimit.

(5) Përqindja e ndihmës nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet në programin për mbështetje financiare në bujqësinë.

(6) Shuma e ndihmës nga paragrafi (4) i këtij neni për njësi të sipërfaqes bujqësore për prodhim bujqësor ose grupe të prodhimeve bujqësore i përcakton Qeveria me rregullën nga neni 47 paragrafi (6) i këtij ligji.

Neni 4

Në Ligjin për plotësimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 74/17) në nenin 1 paragrafi 1 pas fjalëve: "Programi për mbështetje financiare në bujqësinë për vitin 2017" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetje financiare në bujqësinë për vitin 2018", ndërsa pas fjalëve: "Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018".

Në paragrafin 2 pas fjalëve: "Programi për mbështetje financiare në bujqësinë për vitin 2018" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetje financiare në bujqësinë për vitin 2018", ndërsa pas fjalëve; "Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2017" shtohen fjalët: "dhe Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018".

Neni 5

Procedurat e filluara për mbështetje financiare deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në pajtim me Programin për mbështetje financiare në bujqësinë për vitin 2018 dhe Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018, do të përfundojnë në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".